FLETORJA ZYRTARE
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

www.qbz.gov.al

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2021 – Numri: 95

Tiranë – E enjte, 17 qershor 2021

PËRMBAJTJA

		Faqe
Akt normativ i Këshillit të Ministrave nr. 24, datë 16.6.2021	Për miratimin e tekstit të marrëveshjes për prodhimin dhe furnizimin nga dhe ndërmjet *Pfizer Overseas LLC* dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të Shqipërisë, Institutit të Shëndetit Publik dhe ministrit të Shtetit për Rindërtimin.....	9445
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 342, datë 9.6.2021	Për miratimin e marrëveshjes për ndryshimin e marrëveshjes së koncesionit, në lidhje me projektimin, financimin, ndërtimin, pronësinë, operimin, mirëmbajtjen dhe transferimin e një projekti për një hidrocentral të ri në Ashtë, Republika e Shqipërisë, ndërmjet Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (autoriteti kontraktues) dhe Verbund AG (koncesionari) dhe Energji Ashta sh.p.k. (shoqëria e projektit).....	9445
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 357, datë 16.6.2021	Për kryerjen e pagesës së dozave të vaksinave, që rrjedh nga marrëveshja ndërmjet Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, ministrit të Shtetit për Rindërtimin e Institutit të Shëndetit Publik dhe distributorit të autorizuar "*Keymen Ilaç Sanayi ve Ticaret A.Ş.*".....	9453
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 249, datë 11.6.2021	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Polonisë, Sllovakisë, Hungarisë, Gjermanisë, Ukrainës, Çekisë, Rumanisë, Bullgarisë, Belgjikës, Kroacisë, Danimarkës, Francës, Holandës, dhe Italisë.....	9454
Kërkesë e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 42/7, datë 14.6.2021	Për shpronësim për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë private, drurë frutorë, arë dhe ullishte, që preken nga realizimi i projektit "Ndërtimi i segmentit rrugor By-Pass Vlorë".....	9456
Kërkesë e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 37/9, datë 14.6.2021	Për shpronësim për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga projekti "Ndërtimi i rrjetit të kanalizimeve (KUZ) nga Ujësjellës-Kanalizime sh.a., lagjja 'Mbrostar', Fier".....	9458
	Kërkesë për shpalljen të zhdukur të shtetasit Behari Murataj.....	9458

AKT NORMATIV
Nr. 24, datë 16.6.2021

PËR MIRATIMIN E TEKSTIT TË MARRËVESHJES PËR PRODHIMIN DHE FURNIZIMIN NGA DHE NDËRMJET PFIZER OVERSEAS LLC DHE MINISTRISË SË SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE TË SHQIPËRISË, INSTITUTIT TË SHËNDETIT PUBLIK DHE MINISTRIT TË SHTETIT PËR RINDËRTIMIN

Në mbështetje të nenit 101 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe të ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Neni 1
Miratimi i tekstit të marrëveshjes

1. Miratimin e tekstit të marrëveshjes për prodhimin dhe furnizimin nga dhe ndërmjet *Pfizer Overseas LLC* dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të Shqipërisë, Institutit të Shëndetit Publik dhe ministrit të Shtetit për Rindërtimin, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij akti normativ.

2. Marrëveshja për prodhimin dhe furnizimin nga dhe ndërmjet *Pfizer Overseas LLC* dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të Shqipërisë, Institutit të Shëndetit Publik dhe ministrit të Shtetit për Rindërtimin, për shkak të sekretit tregtar dhe kërkesës së shprehur në marrëveshje nga *Pfizer Overseas LLC*, nuk do të publikohet në asnjë *website* të institucioneve apo në Fletoren Zyrtare.

3. Të gjitha institucionet e përfshira në dhënien e mendimit, të miratimit apo që janë pjesë e procesit kanë detyrimin të mos bëjnë publike marrëveshjen bashkëlidhur këtij akti normativ apo pjesë të saj.

4. Detyrimet e organeve shtetërore dhe përjashtimet nga detyrimet për furnizimin e vaksinës anticovid, të përcaktuara në aktin normativ nr. 1, datë 10.1.2021, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, janë të njëjta edhe për këtë marrëveshje, sipas kushteve të tekstit të saj, bashkëlidhur këtij akti normativ.

Neni 2
Efektet financiare

Efektet financiare, që rrjedhin nga marrëveshja bashkëlidhur këtij akti normativ, përballohen nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit për vitin 2021.

Neni 3
Hyrja në fuqi

Ky akt normativ hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

VENDIM
Nr. 342, datë 9.6.2021

PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES PËR NDRYSHIMIN E MARRËVESHJES SË KONCESIONIT, NË LIDHJE ME PROJEKTIMIN, FINANCIMIN, NDËRTIMIN, PRONËSINË, OPERIMIN, MIRËMBAJTJEN DHE TRANSFERIMIN E NJË PROJEKTI PËR NJË HIDROCENTRAL TË RI NË ASHTË, REPUBLIKA E SHQIPËRISË, NDËRMJET MINISTRISË SË INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË (AUTORITETI KONTRAKTUES) DHE VERBUND AG (KONCESIONARI) DHE ENERGJI ASHTA SHPK (SHOQËRIA E PROJEKTIT)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 31, pika 2, e 50, të ligjit nr. 125/2013, "Për koncesionet dhe partneritetin publik privat", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e marrëveshjes për ndryshimin e marrëveshjes së koncesionit, në lidhje me projektimin, financimin, ndërtimin, pronësinë, operimin, mirëmbajtjen dhe transferimin e një

projekti për një hidrocentral të ri në Ashtë, Republika e Shqipërisë, ndërmjet Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (autoriteti kontraktues) dhe Verbund AG (koncesionari) dhe Energji Ashta sh.p.k. (shoqëria e projektit), sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohet Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

MARRËVESHJE
PËR NDRYSHIMIN E MARRËVESHJES SË KONCESIONIT NË LIDHJE ME PROJEKTIMIN, FINANCIMIN, NDËRTIMIN, PRONËSINË, OPERIMIN, MIRËMBAJTJEN DHE TRANSFERIMIN E NJË PROJEKTI PËR NJË HIDROCENTRAL TË RI NË ASHTË, REPUBLIKA E SHQIPËRISË, NDËRMJET MINISTRISË SË INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË (AUTORITETI KONTRAKTUES) DHE *VERBUND AG* (KONCESIONARI) DHE ENERGJI ASHTA SHPK (SHOQËRIA E PROJEKTIT)
28.10.2020

TABELA E PËRMBAJTJES

1. PËRKUFIZIMET DHE INTERPRETIMI
1.1 Përkufizimet
1.2 Interpretimi
2. HYRJA NË FUQI
3. NDRYSHIMET TE MARRËVESHJA E KONCESIONIT
3.1 Ndryshime te neni 1.1
3.2 Ndryshime te neni 2.3
3.3 Zëvendësimi i termave
4. TË NDRYSHME
4.1 E gjithë Marrëveshja
4.2 Përfaqësimet dhe Autoriteti i Korporatës
4.3 Ndarja e dispozitave
4.4 Gjuha
4.5 Mosheqja dorë
4.6 Ligji i zbatueshëm
4.7 Mosmarrëveshjet

KJO MARRËVESHJE (në vijim e referuar si "Marrëveshja") lidhet në Tiranë, sot më 28.10.2020 nga dhe ndërmjet:

1. Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë të Republikës së Shqipërisë, e cila vepron si ministria e linjës përgjegjëse për sektorin e energjisë, në përputhje me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 504, datë 13.9.2017, "Mbi përcaktimin e qëllimit të përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë" (Autoriteti Kontraktues); dhe

2. *Verbund AG* (më parë i quajtur Österreichische Elektrizitätswirtschafts Aktiengesellschaft), një shoqëri aksionare e themeluar, sipas legjislacionit austriak, e regjistruar pranë regjistrit të shoqërive pranë Gjykatës Tregtare të Vjenës, me numër regjistrimi FN 76023z, me seli në Vjenë dhe adresë biznesi në Am Hof 6A, 1011 Vjenë, Austri (Koncesionari); dhe

3. Energji Ashta sh.p.k., një shoqëri me përgjegjësi të kufizuara, e cila vepron në përputhje me ligjet e Shqipërisë, me seli ligjore pranë Hidrocentralit të Ashtës, në fshatin Spatharë, Bushat, Bashkia e Vaut të Dejës, rrethi Shkodër, Shqipëri, e regjistruar pranë regjistrit tregtar të mbajtur nga Qendra Kombëtare e Biznesit, me numër unik të identifikimit të subjektit NUIS K82417005V (Shoqëria e Projektit);

Autoriteti Kontraktues, Koncesionari dhe Shoqëria e Projektit do të referohen, gjithashtu, veçmas si "Pala" dhe bashkërisht si "Palët".

HYRJE

MEQENËSE:

A. Më 30.9.2008, pas zhvillimit të procedurave ndërkombëtare të tenderimit, Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjisë (aktualisht e quajtura Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë) dhe Koncesionari lidhën marrëveshjen e koncesionit lidhur me projektimin, financimin, ndërtimin, zotërimin, operimin, mirëmbajtjen dhe transferimin e hidrocentralit të ri në Ashtë, Republika e Shqipërisë (Marrëveshja e Koncesionit);

B. Në të njëjtën datë, Koncesionari dhe Korporata Elektroenergjetike Shqiptare sh.a. (KESH) lidhën: i. Marrëveshjen për shitjen e energjisë elektrike të gjeneruar nga hidrocentrali i Ashtës (Marrëveshja e Shitjes së e Energjisë); dhe ii. Marrëveshjen e Koordinimit të Kaskadës së lumit Drin (Marrëveshja e Koordinimit të Kaskadës), në lidhje, veçanërisht, me koordinimin e operimit dhe administrimit të kaskadës së lumit Drin, në të cilën

ndodhen hidrocentralet e operuara nga KESH-i dhe Hidrocentrali i Ashtës (së bashku me Marrëveshjen e Koncesionit, Marrëveshja e Shitjes së Energjisë dhe Marrëveshja e Koordinimit të Kaskadës, referuara së bashku në vijim si "Marrëveshjet e Projektit");

C. Më 9.2.2009, Koncesionari njoftoi Autoritetin Kontraktues për kalimin te Shoqëria e Projektit të të drejtave dhe detyrimeve, sipas Marrëveshjes së Koncesionit, me të cilën Koncesionari mbetet përgjegjës në mënyrë solidare;

D. Më 31.3.2010, Koncesionari njoftoi KESH-in për kalimin te Shoqëria e Projektit të të drejtave e detyrimeve të Koncesionarit, sipas Marrëveshjes së Shitjes së Energjisë dhe Marrëveshjes së Koordinimit të Kaskadës.

E. Bazuar në marrëveshjen e kalimit të datës 10.11.2016 nënshkruar mes KESH, Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a. aktualisht i quajtur Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike Group sh.a. (OSHEE Group) dhe Shoqërisë së Projektit, Marrëveshja e Shitjes së Energjisë ka kaluar nga KESH tek OSHEE Group, kështu OSHEE Group u bë Blerësi sipas Marrëveshjes së Shitjes së Energjisë;

F. Bazuar në marrëveshjen e datës 13.1.2017, nënshkruar mes Autoritetit Kontraktues, Koncesionarit dhe Shoqërisë së Projektit, Marrëveshja e Koncesionit u ndryshua për të reflektuar kalimin e të drejtave dhe detyrimeve të Blerësit, sipas Marrëveshjes së Shitjes së Energjisë, nga KESH tek OSHEE Group; ndryshimi i Marrëveshjes së Koncesionit u miratua me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 30, datë 18.1.2017;

G. Furnizuesi i Tregut të Lirë sh.a. (FTL) është një shoqëri aksionare e zotëruar nga shteti me OSHEE Group si aksionar të vetëm;

H. Për shkak të ndryshimeve në sektorin shqiptar të energjisë elektrike, FTL, OSHEE Group dhe Shoqëria e Projektit kanë diskutuar kalimin e të drejtave dhe të detyrimeve të Blerësit, sipas Marrëveshjes së Shitjes së Energjisë, nga OSHEE Group te FTL-ja;

I. Shoqëria e Projektit, OSHEE Group dhe FTL-ja kanë diskutuar dhe rënë dakord për kushtet e një marrëveshje për kalimin e të drejtave dhe detyrimeve të Blerësit, sipas Marrëveshjes së Shitjes së Energjisë, nga OSHEE Group te FTL-ja;

J. Marrëveshja për Shitjen e Energjisë është pjesë përbërëse e Marrëveshjes së Koncesionit, e cila përmban disa parashikime me referenca të kryqëzuara në lidhje me rastin e mospërmbushjes nga ana e Blerësit, në përputhje me Marrëveshjen e Shitjes së Energjisë; për pasojë, transferimi i sugjeruar i të drejtave dhe i detyrimeve të Blerësit, sipas Marrëveshjes së Shitjes së Energjisë nga OSHEE Group te FTL-ja kërkon kryerjen e disa ndryshimeve edhe te Marrëveshja e Koncesionit;

K. Autoriteti Kontraktues, Koncesionari dhe Shoqëria e Projektit kanë biseduar dhe rënë dakord mbi disa ndryshime te Marrëveshja e Koncesionit, të cilat janë të nevojshme, si rrjedhojë e kalimit të propozuar të të drejtave e detyrimeve të Blerësit sipas Marrëveshjes së Shitjes së Energjisë, nga OSHEE Group te FTL-ja; Marrëveshja për kalimin e Marrëveshjes së Shitjes së Energjisë, lidhur ndërmjet OSHEE Group, Shoqërisë së Projektit dhe FTL-së, i bashkëlidhet kësaj Marrëveshjeje, duke u konsideruar pjesë përbërëse e saj.

Atëherë, duke pasur parasysh angazhimet e parashikuara këtu, mjaftueshmëria e të cilave është pranuar, Palët bien dakord si më poshtë:

1. PËRKUFIZIMET DHE INTERPRE-TIMI

1.1 Përkufizimet

Përveçse kur përkufizohen ndryshe në këtë Marrëveshje apo kur kërkohet ndryshe nga konteksti i saj, termat e përkufizuar në Marrëveshjen e Koncesionit do të përdoren këtu me të njëjtin kuptim që u është dhënë në Marrëveshjen e Koncesionit.

1.2 Interpretimi

Përveçse kur kërkohet ndryshe nga konteksti, kjo Marrëveshje do të interpretohet në përputhje me dispozitat interpretuese të Marrëveshjes së Koncesionit.

2. HYRJA NË FUQI

Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi me efekt të plotë pas miratimit të saj nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë (Hyrja në fuqi e Marrëveshjes), miratim i cili do të sigurohet nga Autoriteti Kontraktues.

3. NDRYSHIMET TE MARRËVESHJA E KONCESIONIT

3.1 Ndryshime te neni 1.1

Në nenin 1.1 të Marrëveshjes së Koncesionit bëhen këto ndryshime:

3.1.1 Pas përkufizimit të termit "forcë madhore", shtohet përkufizimi i termit vijuese:

"FTL" do të thotë shoqëria e zotëruar nga shteti, me OSHEE Group, në cilësinë e aksionarit të vetëm";

3.1.2 Përkufizimi i termit "Marrëveshja e shitjes së energjisë" ndryshohet si vijon: "Marrëveshja e shitjes së energjisë" do të thotë marrëveshja merre-ose-paguaj, lidhur më datë 30.9.2008 mes Koncesionarit, në cilësinë e Shitësit dhe KESH-it, në cilësinë e Blerësit, në përputhje me tekstin bashkëlidhur si aneksi A (Marrëveshja e Shitjes së Energjisë), e cila kaloi më pas te Shoqëria e Projektit, në cilësinë e Shitësit dhe te FTL-ja në cilësinë e Blerësit, në përputhje me kushtet dhe afatet e kalimeve përkatëse".

3.1.3 Përkufizimi i termit "OSHEE" zëvendësohet me përkufizimin vijues: "OSHEE Group" do të thotë shoqëria e zotëruar nga shteti, Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike Group sh.a.".

3.1.4 Përkufizimi i termit "Blerësi" ndryshohet si vijon: "Blerësi" do të thotë FTL".

3.2 Ndryshime te neni 2.3

3.2.1 Në nenin 2.3 të Marrëveshjes së Koncesionit, paragrafi "d" ndryshohet si vijon:

d) Nëse në çfarëdo momenti, gjatë kohëzgjatjes së Marrëveshjes për Shitjen e Energjisë, e drejta: i. për të zgjedhur shumicën në këshillin drejtues (ose çdo organ tjetër drejtues) të OSHEE Group; dhe/ose të FTL-së, ose ii) për të udhëhequr ndryshe administrimin dhe politikat e tyre, transferohet në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë te një palë e tretë, e cila nuk është Entitet Shtetëror, atëherë, me kërkesën e shkruar të Koncesionarit, Autoriteti Kontraktues do të sigurojë që Marrëveshja për Shitjen e Energjisë t'i kalohet pa vonesa një entiteti apo shoqërie tjetër publike, të kontrolluar nga një Entitet Shtetëror, që të ketë një kredibilitet financiar të paktën të barasvlershëm me atë të FTL-së, në datën e kësaj Marrëveshjeje, me detyrimin për këtë entitet apo shoqëri tjetër publike për të përmbushur me përpikëri detyrimet e Marrëveshjes për Shitjen e Energjisë. Autoriteti Kontraktues dhe Koncesionari do të bëjnë, gjithashtu, ndryshimet e nevojshme në këtë Marrëveshje, për të reflektuar kalimin e Marrëveshjes për Shitjen e Energjisë.

3.3 Zëvendësimi i termave

3.3.1 Në nenet 2.1(v), 4.1, 11.2.5(b), 11.2.5(c), 11.2.5(d), 11.3(a)(v)(y) dhe (z), të Marrëveshjes së Koncesionit, termi "OSHEE" do të zëvendësohet me termin "FTL".

4. Të ndryshme

4.1 E gjithë Marrëveshja

Kjo Marrëveshje, duke përfshirë dhe hyrjen e saj, përfaqëson të gjithë marrëveshjen ndërmjet Palëve në lidhje me objektin e saj dhe zëvendëson çdo dhe të gjitha marrëveshjet apo rregullimet e mëparshme ndërmjet të njëjtave Palë, pavarësisht nëse kanë qenë në formë verbale apo të shkruar, në lidhje me të njëjtin objekt. Kjo Marrëveshje mund të ndryshohet vetëm nëpërmjet një instrumenti me shkrim të nënshkruar sipas rregullave nga Palët.

Me përjashtim të sa parashikohet shprehimisht këtu, kushtet dhe parashikimet e Marrëveshjes së Koncesionit do të mbeten të pandryshuara.

4.2 Përfaqësimet dhe autoriteti i Korporatës

Koncesionari dhe Shoqëria e Projektit respektivisht i përfaqësojnë dhe i garantojnë Autoritetit Kontraktues se janë marrë të gjitha miratimet e nevojshme paraprake të korporatës, në lidhje me këtë Marrëveshje dhe se nënshkruesit përkatës kanë autoritetin e duhur të korporatës për të lidhur këtë Marrëveshje me efekt të vlefshëm dhe detyrues për Palën përkatëse, pasuesit e tyre ose përfituesit e lejuar.

4.3 Ndarja e dispozitave

Nëse ndonjë prej dispozitave të kësaj Marrëveshjeje konsiderohet e pavlefshme ose e pazbatueshme nga ndonjë autoritet gjyqësor apo autoritet tjetër kompetent, të gjitha dispozitat e tjera të kësaj Marrëveshjeje do të mbeten në fuqi dhe me efekt të plotë dhe nuk do të ndikohen në asnjë mënyrë.

4.4 Gjuha

Kjo Marrëveshje do të nënshkruhet dhe zbatohet në gjuhën angleze. Palët do të bien dakord mbi një përkthim të saj në gjuhën shqipe sa më parë të jetë e mundur, pas nënshkrimit të versionit në gjuhën angleze. Në rast të ndonjë mospërputhjeje, versioni në gjuhën angleze do të ketë përparësi ndaj versionit në gjuhën shqipe.

4.5 Mosheqja dorë

Asnjë Palë nuk do të konsiderohet se ka hequr dorë nga asnjë prej dispozitave të kësaj Marrëveshjeje, me përjashtim kur kjo heqje dorë është kryer shprehimisht me shkrim. Mosinsistimi nga cilado prej Palëve për zbatimin rigoroz të cilësdo prej dispozitave të kësaj Marrëveshje apo përfitimi nga ndonjë prej të drejtave të saj sipas

kësaj Marrëveshje nuk do të konsiderohet si heqje dorë nga cilado Palë prej këtyre dispozitave apo heqje dorë nga ndonjëra prej të drejtave në të ardhmen.

Lidhja e kësaj Marrëveshje nuk do të konsiderohet si heqje dorë nga, dhe nuk ndikon tek asnjë prej të drejtave, pretendimeve ose mosmarrëveshjeve të cilat lindin nga ose në lidhje me Marrëveshjet e Projektit.

4.6 Ligji i zbatueshëm

Kjo Marrëveshje do të rregullohet dhe interpretohet në përputhje me ligjet e Republikës së Shqipërisë.

4.7 Mosmarrëveshjet

Çdo mosmarrëveshje që lind nga ose në lidhje me Marrëveshjen do të zgjidhet në përputhje me procedurat e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve, siç parashikohet nga Marrëveshja e Koncesionit.

Palët e mësipërme kanë lidhur këtë Marrëveshje, duke e nënshkruar në 4 (katër) kopje origjinale, nga përfaqësuesit e tyre të autorizuar në datën e shënuar më sipër.

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë e Republikës së Shqipërisë
Nënshkrimi: _____
Nga: Ilir Bejtja
Titulli: Zëvendësministër

Verbund AG
Nënshkrimi:
Nga: Dietmar Reiner
Titulli: Përfaqësues i autorizuar

Energji Ashta sh.p.k.
Nënshkrimi: Nga: Dietmar Reiner
Titulli: Administrator

MARRËVESHJE
PËR KALIMIN E MARRËVESHJES SË SHITJES SË ENERGJISË, NË LIDHJE ME NJË PROJEKT TË RI HIDROCENTRALI NË ASHTË, REPUBLIKA E SHQIPËRISË, NDËRMJET OPERATORIT TË SHPËRNDARJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE GROUP SHA, ENERGJI ASHTA SHPK DHE FURNIZUESI I TREGUT TË LIRË SHA
30.4.2020

TABELA E PËRMBAJTJES

1. PËRKUFIZIMET DHE INTERPRE-TIMI
1.1 Përkufizimet
1.2 Interpretimi
2. HYRJA NË FUQI
3. KALIMI
4. PRETENDIMET PËR PAGESA
5. NDRYSHIMET NË MARRËVESHJEN PËR SHITJEN E ENERGJISË
5.1 Referencat tek OSHEE
6. AFATI
7. TË NDRYSHME
7.1 Marrëveshja e plotë
7.2 Përfaqësimet dhe Autoriteti i Korporatës
7.3 Ndarja e dispozitave
7.4 Gjuha
7.5 Mosheqja dorë
7.6 Njoftimet
7.7 Ligji i zbatueshëm
7.8 Mosmarrëveshjet

KJO MARRËVESHJE (në vijim e referuar si "Marrëveshja") është lidhur sot më datë 30.4.2020, nga dhe ndërmjet:

1. Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike Group sh.a., një shoqëri aksionare e themeluar dhe që vepron në përputhje me ligjet e Republikës së Shqipërisë, me seli ligjore pranë Njësia Administrative nr. 7, bulevardi "Gjergj Fishta", ndërtesa nr. 88, h. l, 1023, Tiranë, Shqipëri, e regjistruar pranë Regjistrit Tregtar, të mbajtur nga Qendra Kombëtare e Biznesit, me numër unik identifikimi NUIS K72410014H, e përfaqësuar sipas rregullave në këtë Marrëveshje nga z. Adrian Çela, në cilësinë e Administratorit (në vijim i referuar si "OSHEE Group" ose "Kaluesi"); dhe

2. Energji Ashta sh.p.k., një shoqëri me përgjegjësi të kufizuara që vepron në përputhje me

ligjet e Republikës së Shqipërisë, me seli ligjore pranë Hidrocentralit të Ashtës, në fshatin Spatharë, Bushat, Bashkia e Vaut të Dejës, rrethi Shkodër, Shqipëri, e regjistruar pranë Regjistrit Tregtar, të mbajtur nga Qendra Kombëtare e Biznesit, me numër unik identifikimi NUIS K82417005V, e përfaqësuar sipas rregullave në këtë Marrëveshje nga z. Dietmar Reiner dhe z. Peter Stelzer, në cilësinë e drejtorëve të përgjithshëm/ administratorëve (në vijim e referuar si "EA", "Shoqëria e Projektit" ose "Shitësi); dhe

3. Furnizuesi i Tregut të Lirë sh.a. një shoqëri aksionare e themeluar dhe që vepron në përputhje me ligjet e Republikës së Shqipërisë, me seli ligjore pranë Njësia Administrative nr. 7, bulevardi "Gjergj Fishta", ndërtesa nr. 88, h. 1, 1023, Tiranë, Shqipëri, e regjistruar pranë Regjistrit Tregtar, të mbajtur nga Qendra Kombëtare e Biznesit, me numër unik identifikimi NUIS L81530029T, e përfaqësuar sipas rregullave në këtë Marrëveshje nga znj. Erina Rexhepi në cilësinë e në cilësinë e administratorit (në vijim e referuar si "FTL" ose "Përfituesi).

FTL Group, EA-ja dhe FTL-ja referohen, gjithashtu, veçmas si "Palë" dhe bashkërisht si "Palët".

HYRJE

MEQENËSE:

A. Më 30.9.2008, pas zhvillimit të procedurave ndërkombëtare të tenderimit, Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjisë (aktualisht e referuar si Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë) dhe Österreichische Elektrizitäswirtschafts Aktiengesellschaft (aktualisht e titulluar "Verbund AG" - në vijim referuar si "Koncesionari") kanë lidhur marrëveshjen e koncesionit për projektimin, financimin, ndërtimin, zotërimin, operimin, mirëmbajtjen dhe transferimin e hidrocentralit të ri në Ashtë, Republika e Shqipërisë (Marrëveshja e Koncesionit);

B. Në të njëjtën datë, Koncesionari dhe Korporata Elektro Energjitike Shqiptare sh.a. (KESSH) kanë lidhur: i. Marrëveshjen për shitjen e energjisë elektrike të prodhuar nga Hidrocentrali i Ashtës (Marrëveshja për Shitjen e Energjisë); dhe ii. Marrëveshja për Koordinimit të Kaskadës së lumit Drin (Marrëveshja për Koordinimin e kaskadës), në veçanti, në lidhje me koordinimin e operimit dhe administrimit të kaskadës së lumit Drin, në të cilën ndodhen hidrocentralet e operuara nga KESH dhe Hidrocentrali i Ashtës (së bashku me Marrëveshjen e Koncesionit, Marrëveshjen për Shitjen e Energjisë dhe Marrëveshjen për Koordinimin e Kaskadës, të referuara bashkërisht në vijim si "Marrëveshjet e Projektit");

C. Më 9.2.2009, Koncesionari njoftoi Autoritetin Kontraktues për kalimin te Shoqëria e Projektit të të drejtave dhe detyrimeve të parashikuara në Marrëveshjen e Koncesionit, me të cilën Koncesionari mbetet personalisht dhe bashkërisht përgjegjës;

D. Më 31.3.2010, Koncesionari njoftoi KESH-in për kalimin te Shoqëria e Projektit të të drejtave dhe të detyrimeve të Koncesionarit, sipas Marrëveshjes për Shitjen e Energjisë dhe Marrëveshjes për Koordinimin e Kaskadës;

E. Nëpërmjet shkresës- EA/KESH 027, njoftimi i datës së hyrjes në fuqi të Marrëveshjes për Shitjen e Energjisë - Projekti i Hidrocentralit të Ashtës, EA-ja njoftoi KESH-in se Marrëveshja për Shitjen e Energjisë ka hyrë në fuqi më 28.3.2013 (Hyrja në fuqi). Furnizimi me energji elektrike nga Shoqëria e Projektit nisi më 1.4.2013;

F. Marrëveshja për Shitjen e Energjisë është lidhur për një periudhë pesëmbëdhjetë (15- vjeçare) nga hyrja në fuqi;

G. Mbi bazën e marrëveshjes së kalimit datë 10.11.2016 nënshkruar mes KESH-it, OSHEE Group dhe EA-së, Marrëveshja për Shitjen e Energjisë u kalua nga KESH-i tek OSHEE Group, kështu OSHEE Group u bë Blerësi sipas Marrëveshjes për Shitjen e Energjisë;

H. Mbi bazën e marrëveshjes datë 13.1.2017 nënshkruar mes Autoritetit Kontraktues, Koncesionarit dhe EA-së, Marrëveshja e Koncesionit u ndryshua për të reflektuar kalimin e të drejtave dhe të detyrimeve të Blerësit, sipas Marrëveshjes për Shitjen e Energjisë nga KESH-i tek OSHEE Group; ndryshimi i Marrëveshjes së Koncesionit u miratua me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 30, datë 18.1.2017;

I. FTL-ja është një shoqëri aksionare e zotëruar tërësisht nga OSHEE Group;

J. Si rrjedhojë e ndryshimeve në sektorin shqiptar të energjisë elektrike, OSHEE Group dhe FTL-ja diskutuan dhe ranë dakord me EA-në, në cilësinë e Shitësit, për transferimin e të drejtave dhe të detyrimeve të Blerësit, sipas Marrëveshjes për

Shitjen e Energjisë, nga OSHEE GROUP te FTL-ja Group;

K. EA-ja, OSHEE Group dhe FTL-ja kanë diskutuar dhe rënë dakord, mbi kushtet për kalimin e marrëveshjes së kalimit të të drejtave dhe të detyrimeve të blerësit, sipas Marrëveshjes për Shitjen e Energjisë Elektrike nga OSHEE Group te FTL-ja;

L. Marrëveshja për Shitjen e Energjisë është pjesë përbërëse e Marrëveshjes së Koncesionit, e cila përmban disa parashikime me referenca të kryqëzuara për rastin e mospërmbushjes nga ana e Blerësit, në përputhje me Marrëveshjen për Shitjen e Energjisë; kështu kalimi i sugjeruar i të drejtave dhe i detyrimeve të Blerësit, sipas Marrëveshjes për Shitjen e Energjisë, nga OSHEE Group te FTL-ja, kërkon kryerjen e disa ndryshimeve edhe në Marrëveshjen e Koncesionit,

M. Autoriteti Kontraktues, Koncesionari dhe EA-ja kanë diskutuar dhe rënë dakord mbi ndryshimet e Marrëveshjes së Koncesionit, të cilat janë të nevojshme, si rrjedhojë e kalimit të propozuar të të drejtave dhe të detyrimeve të Blerësit, sipas Marrëveshjes për Shitjen e Energjisë, nga OSHEE GROUP te FTL-ja;

Atëherë, duke pasur parasysh angazhimet e parashikuara këtu, mjaftueshmëria e të cilave është pranuar, Palët bien dakord si më poshtë:

1. PËRKUFIZIMET DHE INTERPRETIMI

1.1 Përkufizimet

Me përjashtim nëse janë të përkufizuara ndryshe nga kjo Marrëveshje dhe kur të kërkohet ndryshe nga konteksti (duke përfshirë shtojcat e saj), shprehjet e përkufizuara në Marrëveshjen për Shitjen e Energjisë do të përdoren këtu me të njëjtin kuptim që u është dhënë në Marrëveshjen për Shitjen e Energjisë.

1.2 Interpretime

Me përjashtim të rastit kur kërkohet ndryshe nga konteksti, kjo Marrëveshje do të interpretohet në përputhje me dispozitat interpretuese të Marrëveshjes për Shitjen e Energjisë.

2. HYRJA NË FUQI

Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi dhe me efekt të plotë pasi: i. FTL-ja të ketë siguruar lëshimin e Garancisë Bankare të Blerësit, sipas nenit 3.3 të Marrëveshjes për Shitjen e Energjisë; dhe pas ii. nënshkrimit nga Autoriteti Kontraktues, Koncesionari dhe EA-ja të marrëveshjes për ndryshimin e Marrëveshjes së Koncesionit, të referuar në pikën "M" të hyrjes, këtu më lart (Hyrja në fuqi e Marrëveshjes).

3. KALIMI

3.1 Me Hyrjen në fuqi të Marrëveshjes dhe në zbatim të kushteve dhe afateve të saj, OSHEE Group në cilësinë e kaluesit, i kalon FTL-së në cilësinë e Përfituesit, të gjitha të drejtat dhe detyrimet e Blerësit ,sipas Marrëveshjes për Shitjen e Energjisë, dhe FTL-ja si Përfitues pranon këtë kalim dhe merr përsipër të gjitha të drejtat dhe detyrimet e Blerësit (të Kaluesit) sipas Marrëveshjes për Shitjen e Energjisë (Kalimi).

4. PRETENDIMET PËR PAGESA

4.1 OSHEE Group si kalues dhe FTL si Përfitues, do të mbeten përgjegjës në mënyrë solidare ndaj EA-së, në lidhje me çdo pretendim për pagesa të prapambetura në përputhje me Marrëveshjen për Shitjen e Energjisë për periudha që i paraprijnë datës së hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje. Pagesat e FTL-së do të bëhen të detyrueshme dhe të pagueshme sipas parashikimeve të nenit 3.2 të Marrëveshjes për Shitjen e Energjisë, nga dita në të cilën FTL-ja merr fatura/t në emrin e saj.

5. NDRYSHIMET NË MARRËVESHJEN PËR SHITJEN E ENERGJISË

5.1 Referencat tek OSHEE-ja

Që nga hyrja në fuqi e kësaj Marrëveshjeje, çdo referencë tek OSHEE në Marrëveshjen për Shitjen e Energjisë do të zëvendësohet me referencë te FTL-ja.

6. AFATI

Me plotësimin e kushteve për hyrjen në fuqi të Marrëveshjes, kalimi i të drejtave dhe i detyrimeve të Blerësit do të kryhet me efekt, duke nisur nga data 1 janar 2020 dhe do të mbetet në fuqi deri në mbarimin e afatit të vlefshmërisë së Marrëveshjes për Shitjen e Energjisë.

7. TË NDRYSHME

7.1 Marrëveshja e plotë

Kjo Marrëveshje, duke përfshirë dhe hyrjen e saj, përfaqëson të gjithë marrëveshjen ndërmjet Palëve, në lidhje me objektin e saj dhe zëvendëson çdo dhe të gjitha marrëveshjet apo mirëkuptimet e mëparshme, qofshin me gojë apo me shkrim, ndërmjet po këtyre Palëve, në lidhje me të njëjtin objekt. Kjo Marrëveshje mund të ndryshohet vetëm nëpërmjet një instrumenti të shkruar të nënshkruar rregullisht nga Palët.

7.2 Përfaqësimet dhe Autoriteti i Korporatës

OSHEE Group, EA-ja dhe FTL-ja përfaqësojnë dhe i garantojnë njëra-tjetrës se të gjitha miratimet e nevojshme paraprake të korporatës dhe të aksionarëve janë marrë rregullisht në lidhje me këtë Marrëveshje dhe se nënshkruesit përkatës kanë autoritetin e duhur të korporatës për të lidhur këtë Marrëveshje dhe për të angazhuar Palën përkatëse, pasuesit e tyre ose përfituesit e lejuar.

7.3 Ndarja e dispozitave

Nëse ndonjë prej dispozitave të kësaj Marrëveshje konsiderohet e pavlefshme ose e pazbatueshme nga ndonjë autoritet gjyqësor apo autoritet tjetër kompetent, të gjitha dispozitat e tjera të kësaj Marrëveshje do të mbeten në fuqi dhe me efekt të plotë dhe nuk do të ndikohen në asnjë mënyrë.

7.4 Gjuha

Kjo Marrëveshje do të nënshkruhet dhe zbatohet në gjuhën angleze. Palët do të bien dakord mbi një përkthim të saj në gjuhën shqipe sa më parë të jetë e mundur pas nënshkrimit të versionit në gjuhën angleze. Në rast të ndonjë mospërputhjeje, versioni në gjuhën angleze do të ketë përparësi ndaj versionit në gjuhën shqipe. Çdo komunikim dhe njoftim ndërmjet Palëve në lidhje me këtë do të kryhet në gjuhën angleze ose shqipe (së bashku me një përkthim në anglisht, nëse është e mundur).

7.5 Mosheqja dorë

Asnjë Palë nuk do të konsiderohet se ka hequr dorë nga asnjë prej dispozitave të kësaj Marrëveshjeje, me përjashtim kur kjo heqje dorë është kryer shprehimisht me shkrim. Mosinsistimi nga cilado prej Palëve për zbatimin rigoroz të cilësdo prej dispozitave të kësaj Marrëveshjeje apo për të përfituar nga ndonjë prej të drejtave të saj sipas kësaj Marrëveshjeje nuk do të konsiderohet si heqje dorë nga cilado Palë prej këtyre dispozitave apo heqje dorë nga ndonjëra prej të drejtave në të ardhmen.

Lidhja e kësaj Marrëveshjeje nuk do të konsiderohet si heqje dorë nga, dhe nuk ndikon tek asnjë prej të drejtave, pretendimeve ose mosmarrëveshjeve të cilat lindin nga ose në lidhje me Marrëveshjen e Projektit.

7.6 Njoftimet

Çdo njoftim ose komunikim tjetër në lidhje me këtë Marrëveshje do të kryhet në zbatim të nenit 12.7 të Marrëveshjes për Shitjen e Energjisë tek adresat e mëposhtme:

Për OSHEE Group:

Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike Group sh.a.

Njësia Administrative nr. 7, bulevardi "Gjergj Fishta"

Ndërtesa nr. 88, h. 1, 1023, Tiranë, Shqipëri.

Në vëmendje të: Administratorit

Tel.: +355

Faks: +355

Për EA-në: ENERGJI ASHTA

Hidrocentrali i Ashtës, fshati Spatharë, Bushat, Bashkia e Vaut të Dejës,`

Qarku Shkodër, Shqipëri

Në vëmendje të: drejtorit të përgjithshëm

Tel.: +355 (4) 4504236

Faks: +355 (4) 4504236

Për FTL-në:

Furnizuesi i Tregut të Lirë sh.a.

Njësia Administrative nr. 7, bulevardi "Gjergj Fishta"

Ndërtesa nr. 88, h. 1, 1023, Tiranë, Shqipëri.

Në vëmendje të: Administratorit

Tel.: +355

Fax: +355

Adresat e mësipërme do të përdoren, gjithashtu, për njoftimet sipas Marrëveshjes për Shitjen e Energjisë, me përjashtim nëse njoftohet një ndryshim adrese, sipas nenit 12.7 të Marrëveshjes për Shitjen e Energjisë.

7.7 Ligji i zbatueshëm

Kjo Marrëveshje do të rregullohet dhe interpretohet në përputhje me ligjet e Republikës së Shqipërisë.

7.8 Mosmarrëveshjet

Në rast të ndonjë mosmarrëveshjeje mbi ose në lidhje me Marrëveshjen (Mosmarrëveshja), secila prej Palëve do t'i dërgojë Palës tjetër një njoftim me shkrim për këtë, pas të cilit Palët do të takohen menjëherë dhe do të synojnë në mirëbesim të arrijnë një zgjidhje miqësore

Në pamundësi të një marrëveshjeje miqësore brenda 30 (tridhjetë) ditësh nga marrja njoftimit të parashikuar më lart, cilado prej Palëve mund t'ia

referojë këtë Mosmarrëveshje arbitrazhit ndërkombëtar.

Të gjitha procedimet e arbitrazhit në lidhje me sa më lart do të zhvillohen dhe zgjidhen përfundimisht në Paris, Francë dhe do të kryhen në zbatim të Rregullave të Arbitrazhit të Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë, para një paneli prej 3 (tre) arbitrash të caktuar në përputhje me këto rregulla.

Arbitrazhi do të zhvillohet në gjuhën angleze dhe të gjitha dokumentet e dërguara në lidhje me këto procedime do të jenë në gjuhën angleze ose të shoqëruara nga një përkthim i vërtetuar në gjuhën angleze.

Kjo Marrëveshje, si dhe Marrëveshja për Shitjen e Energjisë dhe të drejtat dhe detyrimet e Palëve do të mbeten në fuqi dhe efekt në pritje të vendimit në këtë procedim arbitrazhi, vendimi i cili, nëse është e përshtatshme, do të përcaktojë nëse dhe kur do të jetë efektive zgjidhja.

Palët e mësipërme kanë lidhur këtë Marrëveshje, duke e nënshkruar në 4 (katër) ekzemplarë origjinalë, nga përfaqësuesit e tyre të autorizuar.

Operatori i shpërndarjes së Energjisë Elektrike Group sh.a.
Nënshkrimi:
Emri: Adrian Çela
Titulli: Administrator

Energji Ashta sh.p.k.
Nënshkrimi:
Emri: Dietmar Reiner & Peter Stelzer
Titulli: Drejtor Ekzekutiv / Administrator

Furnizuesi i Tregut të Lirë sh.a.
Nënshkrimi:
Emri: Erina Rexhepi
Titulli: Administrator

VENDIM
Nr. 357, datë 16.6.2021

PËR KRYERJEN E PAGESËS SË DOZAVE TË VAKSINAVE, QË RRJEDH NGA MARRËVESHJA NDËRMJET MINISTRISË SË SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE, MINISTRIT TË SHTETIT PËR RINDËRTIMIN E INSTITUTIT TË SHËNDETIT PUBLIK DHE DISTRIBUTORIT TË AUTORIZUAR "*KEYMEN ILAÇ SANAYI VE TICARET A.Ş.*"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të neneve 5 e 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar; të nenit 14, të ligjit nr. 137/2020, "Për buxhetin e vitit 2021", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe të ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kryerjen nga Instituti i Shëndetit Publik të pagesës së dozave të vaksinave anticovid-19, sipas kushteve të përcaktuara në marrëveshjen ndërmjet Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, ministrit të Shtetit për Rindërtimin e Institutit të Shëndetit Publik dhe distributorit të autorizuar "*Keymen Ilaç Sanayi ve Ticaret A.Ş.*", të miratuar me aktin normativ nr. 22, datë 21.5.2021, të Këshillit të Ministrave.

2. Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në buxhetin e miratuar për vitin 2021, për Institutin e Shëndetit Publik, në llogarinë ekonomike 6050000 (produkti 91305AH) të programit të shëndetit publik (07450), i shtohet ekuivalenti në lekë (sipas kursit zyrtar të këmbimit në datën e pagesës) i shumës 10 000 000 (dhjetë milionë) USD, të pagesës së dozave të vaksinave anticovid-19, sipas kushteve të përcaktuara në marrëveshjen ndërmjet Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, ministrit të Shtetit për Rindërtimin e Institutit të Shëndetit Publik dhe distributorit të autorizuar "*Keymen Ilaç Sanayi ve ticaret A.Ş.*", të miratuar me aktin normativ nr. 22, datë 21.5.2021, të Këshillit të Ministrave.

3. Fondi, sipas pikës 2, të këtij vendimi, të përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit, miratuar për vitin 2021.

4. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, ministri i Shtetit për Rindërtimin, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Instituti i Shëndetit Publik për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

URDHËR
Nr. 249, datë 11.6.2021

PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ SËMUNDJES SË INFLUENCËS AVIARE ME PATOGJENITET TË LARTË TË SHPENDËVE, TË SHFAQUR NË SHTETIN E POLONISË, SLLOVAKISË, HUNGARISË, GJERMANISË, UKRAINËS, ÇEKISË, RUMANISË, BULLGARISË, BELGJIKËS, KROACISË, DANIMARKËS, FRANCËS, HOLANDËS, DHE ITALISË

Mbështetur në nenin 102, pika 4 të Kushtetutës; në nenin 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, "Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, si dhe në informacionin e përditësuar, të marrë nga faqja zyrtare e Organizatës Ndërkombëtare të Mbrojtjes së Shëndetit të Kafshëve (OIE),

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe tranzitimit, për në territorin e Republikës së Shqipërisë, të:

a) shpendëve të gjallë shtëpiakë dhe të egër;
b) zogjve 24 orësh;
c) shpendëve dekorativë;
ç) materialit biologjik të shpendëve;
d) vezëve të shpendëve;
dh) mishit të shpendëve;
e) nënprodukteve të shpendëve.

Nga shtetet e mëposhtme:

Nga shteti i Polonisë: përkatësisht provinca Wielkopolskie, rajoni Ostrowski, nënrajoni Przygodzice; përkatësisht provinca Zachodnio-Pomorskie, rajoni Mysliborsk, nënrajoni Mysliborz; përkatësisht provinca Wielkopolskie, rajoni Kolski, nënrajoni Dabie, rajoni wolsztynski, nënrajoni Siedlec; përkatësisht provinca Wielkopolskie, rajoni Ostrowski, nënrajoni Ostrow; përkatësisht provinca Warminsko-Mazurskie, rajoni Ostrodzki, nënrajoni Grunwald; përkatësisht provinca Opolskie, rajoni Kedzierzynsko-Kozielski, nënrajoni Kedzierzyn-Kozle; përkatësisht provinca Wielkopolskie, , rajoni Grodziski, rrethi Rakoniewice dhe Wielichowo, rajoni Szamotulski, rrethi Pniewy, rajoni Klodzki, rrethi Klodzko; përkatësisht provinca Mazowieckie, rajoni Siedlecki, rrethi Suchozebry, rajoni Gostyninski, rrethi Gostynin; përkatësisht provinca Warminsko-Mazurskie, rajoni Nowomiejski, rrethi Grodziczno, rajoni Piski, rrethi Pisz; përkatësisht provinca Lubelskie, rajoni Leczynski, rrethi Ludwin, rajoni Radzynski, rrethi Wohyn; përkatësisht provinca Pomorskie, rajoni Slupski, rrethi Kobylnica, rajoni Wejherowsk, rrethi Kielno.

Nga shteti i Sllovakisë: përkatësisht provinca Nitra, rrethi Nitra; fshati Zbehy, provinca Trnava, rrethi Trnava, fshati Cifer, rrethi Dunajská Streda, fshati Dobrohošt; provinca Trencin, rrethi Prievidza, qyteti Bojnice; provinca Zilina, rrethi Cadca, fshati Stará Bystrica.

Nga shteti i Hungarisë: përkatësisht nga rajoni Bacs-Kiskun, fshati Csólyospálos, Szank, Kiskunfélegyháza, Kiskunmajsa, Kömpöc, Jászszentlászló, Nyárlőrinc, Mélykút, Bócsa, Soltvadkert, Bugac, Császártöltés, Kunfehértó, Orgovány, Kelebia, Jánoshalma, Kiskunhalas, Tázlár, Rem, Szank, Kisszállás, Petofiszállás; përkatësisht rajoni Komárom-Esztergom, fshati Ács, përkatësisht rajoni Csongrad, fshati Ruzsa, Forráskút, Zsombó, Pusztaszer, Csengele; përkatësisht rajoni Hajdu-Bihar, fshati Letavertes, rajoni Bekes, fshati Battonya, Nagykamarás, Kondoros, Kisdombegyház, Battonya.

Nga shteti i Gjermanisë: përkatësisht provinca Baden-Wurttemberg, rrethi Hohenlohekreis, fshati Bretzfeld; provinca Niedersachsen, rrethi Aurich, fshati Dornum; provinca Sachsen-Anhalt, rrethi Börde, fshati Bülstringen; provinca Baden-Wurttemberg, rrethi Hohenlohekreis, Bashkia Bretzfeld; provinca Sachsen-Anhalt, rrethi Börde, Bashkia Bülstringen, provinca Schleswig-Holstein, rrethi Nordfriesland, Bashkia Langeneß, Emmelsbüll-Horsbüll,

Pellworm, rrethi Segeberg, Bashkia Heidmühlen, rrethi Dithmarschen, Bashkia Neufelderkoog dhe Gudendorf; provinca Mecklenburg-Vorpommern, rrethi Vorpommern-Rügen, Bashkia Zingst; provinca Mecklenburg-Vorpommern, rrethi Vorpommern-Rügen, Bashkia Rambin, rrethi Rostock, Bashkia Neubukow, rrethi Mecklenburgische Seenplatte, Bashkia Lärz, rrethi Nordwestmecklenburg, Bashkia Gadebusch, rrethi Vorpommern-Greifswald, Bashkia Wusterhusen, rrethi Ludwigslust – Parchim, Bashkia Dömitz; provinca Niedersachsen, rrethi Aurich, Bashkia Großheide, rrethi Cloppenburg, Bashkia Cloppenburg, Bösel, rrethi Oldenburg, Bashkia Prinzhöfte, rrethi Cuxhaven, Bashkia Wurster Nordseeküste, rrethi Wittmund, Bashkia Wittmund; provinca Sachsen, rrethi Leipzig, Bashkia Grimma; provinca Brandenburg, rrethi Spree-Neiße, Bashkia Schenkendöbern, rrethi Prignitz, Bashkia Pirow; provinca Bayern, rrethi Bayreuth, Bashkia Pottenstein.

Nga shteti i Ukrainës: përkatësisht nga qyteti Nikolayev, rrethi Nova Odesa, fshati Kandybyne dhe Novomatviivske, rrethi Ochakiv, fshati Yaselka, rrethi Mykolaiv, fshati Trykhaty; përkatësisht nga qyteti Kiev, rrethi Ivankiv, fshati Leonivka.

Nga shteti i Çekisë: përkatësisht provinca Vysocina, rrethi Zdar nad Sazavou, fshati Stepanov nad Svratkou; provinca Pardubický, rrethi Pardubice, fshati Slepotice; provinca Jihoceský, rrethi Tábor, fshati Dlouhá Lhota.

Nga shteti i Rumanisë: përkatësisht rajoni Maramures, provinca Seini.

Nga shteti i Bullgarisë: përkatësisht provinca Plovdiv, Kardzali, fshati Perperek dhe Trilistnik.

Nga shteti i Belgjikës: përkatësisht provinca West – Vlaanderen, Bashkia Menen.

Nga shteti i Kroacisë: përkatësisht qyteti Koprivnicko-Krizevacka, Bashkia Novigrad Podravski, fshati Delovi.

Nga shteti i Danimarkës: përkatësisht rajoni West, Bashkia Randers, fshati Tustrup, Bashkia Viborg, fshati Viborg.

Nga shteti i Francës: përkatësisht në ndarjen Yvelines, komuna Saint Cyr l'Ecole; ndarja Corse-Du-Sud, komuna Ajaccio; ndarja Haute – Corse, komuna Biguglia, Focicchia, Muro, Aregno, Bisinghi; e gjithë ndarja Landes; ndarja Vendée, komuna St Maurice des Noues, Saint-Christophe-du-Ligneron; ndarja Deux-Sèvres, komuna St Sauveur; ndarja Hautes-Pyrénées, komuna Labatut-Riviere, Estirac, Garderes; ndarja Pyrénées-Atlantiques, komuna Baigts-de-Bearn, Prechacq-Navarrenx, Lichos, Garlin, Uzan, Orthez, Louvie-Juzon, Saint- Girons-en-Bearn, Urdes, Lay-Lamidou, Garlin, Dognen, Sallespisse, Charre, Saint-Armou, Poey-D'Oloron, Nousty, Arget Puyoo, Ogenne-Camptort, Aren, Bidache, Saucede, Montaner, Loncon, Castetpugon, Amorots - Succos, Momas, Arzacq Arraziguet; ndarja Gers, komuna Montreal, Sainte-Christie-D'Armagnac, Barcelonne-du-Gers, Salles-D'Armagnac, Laujuzan, Manciet, Houga, Mauleon-D'Armagnac, Ayzieu, Barcelonne-du-Ger, Poey-D'Oloron, Castelnau D'Auzan Labarrer, Corneillan, Castex-D'Armagnac, Larroque-Sur-L'Osse, Lanne-Soubiran, Sorbets, Manciet, Monguilhem, Segos, Mauleon-D'Armagnac, Aurensa; ndarja Haute Garonne, komuna Grenade; ndarja Lot-Et-Garonne, komuna Sainte- Maure-de-Peyriac, Saint-pe-Saint-Simon.

Nga shteti i Hollandës: përkatësisht provinca Gelderland, fshati Altforst, Puiflijk, Terwolde; provinca Groningen, fshati Lutjegast; provinca Friesland, fshati Witmarsum, Sint Annaparochie, Buitenpost; provinca Utrecht, fshati Hekendorp; provinca Zuid-Holland, fshati Maasland; provinca Noord-Brabant, fshati Moergestel.

Nga shteti i Italisë: përkatësisht provinca Emilia-Romagna, rrethi Ravenna, komuna Lugo.

2. Certifikata veterinare të garantojë origjinën e ngarkesës së ardhur.

3. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të informojë rregullisht, Drejtorinë e Politikave dhe Programeve të Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë dhe Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve për çdo ngarkesë të shpendëve të gjallë shtëpiakë dhe të egër, zogjve 24 orësh, shpendëve dekorativë, materialit biologjik, vezëve të shpendëve, mishit të shpendëve dhe nënprodukteve të shpendëve që vijnë nga vendet e sipërcituara në pikën 1.

4. Urdhri nr. 173, datë 23.4.2021, "Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Polonisë, Sllovakisë, Hungarisë, Gjermanisë, Ukrainës, Izraelit, Çekisë, Rumanisë, Bullgarisë, Belgjikës, Kroacisë, Danimarkës, Francës, Holandës, Lituanisë dhe Italisë", dhe

urdhri nr. 238, datë 4.6.2021, "Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së Influencës Aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Greqisë", shfuqizohet.

5. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Politikave dhe Programeve të Bujqësisë, Sigurisë Ushqimore dhe Zhvillimit Rural, Drejtoria e Politikave dhe Programeve të Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Milva Ekonomi

KËRKESË
Nr. 42/7, datë 14.6.2021

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Agjencia Shtetërore për Shpronësimin shpall kërkesën për shpronësim për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë private, drurë frutorë, arë dhe ullishte, që preken nga realizimi i projektit "Ndërtimi i segmentit rrugor By-Pass Vlorë".

Subjekti kërkues i këtij projekti është Autoriteti Rrugor Shqiptar.

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim, për pasuritë e paluajtshme, pronë private, drurë frutorë, arë dhe ullishte, të cilët do të kompensohen sipas vlerësimit paraprak të llogaritur, bazuar në VKM-në nr. 89, datë 3.2.2016 "Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë", në VKM-në nr. 138, datë 23.3.2000, "Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik", i ndryshuar, dhe udhëzimin nr. 1, datë 5.10.2000 "Për kriteret teknike të përllogaritjes së vlerës së bimëve drufrutorë që shpronësohen për interes publik, në rastet kur mungojnë treguesit e deklaruar të shitblerjes", sipas tabelës paraprake bashkëlidhur.

Vlera totale paraprake e shpronësimit është **8,544,392 (tetë milionë e pesëqind e dyzet e katër mijë e treqind e nëntëdhjetë e dy) lekë**.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
KRYETAR I KOMISIONIT TË POSAÇËM
TË SHPRONËSIMEVE
Erlis Hereni

LISTA EMËRORE PARAPRAKE E PRONARËVE , TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, DRUFRUTORË, ARË DHE ULLISHTE QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR "BY -PASS VLORË"

Nr.	PRONARI			LLOJI I PASURISË				VLERËSIMET			VLERA	
	Emri i pronarit	ZK	NR. PAS.	ARË/VRESHT	ULLISHTE	KULLOTË	SIP. TOTALE	SIP. E VLERËSUAR	ÇMIMI	Vlera (lekë)	TOTALE (LEKË)	Shënime
1	HAXHI ISA BEGAJ	2074	373/19	arë						14,000	**14,000**	P.verbal/Konf. nga ASHK-ja
2	KIMET BATJAR HOXHAJ	2074	887/5		ullishte					270,000	**270,000**	P.verbal/Konf. nga ASHK-ja
3	LICO SADIK BESHAJ	2074	727/3		ullishte					158,000	**158,000**	P.verbal/Konf. nga ASHK-ja
4	VIKTOR BESHAJ	2074	152/6		ullishte					252,000	**252,000**	P.verbal/Konf. nga ASHK-ja
5	VIKTOR BESHAJ	2074	160/17		ullishte							P.verbal/Konf. nga ASHK-ja
6	KASTRIOT BATJAR HOXHAJ	2074	887/1		ullishte					555,000	**555,000**	P.verbal/Konf. nga ASHK-ja
7	HAMZA NAMIK DERAJ	2074	161	arë						548,000	**548,000**	P.verbal/Konf. nga ASHK-ja
8	FASLLI HIQMET LAZAJ	2074	564/9/2		ullishte					420,000	**420,000**	P.verbal/Konf. nga ASHK-ja
9	ADHURIM HAMZA DERAJ	2074	941/2		ullishte					414,000	**414,000**	P.verbal/Konf. nga ASHK-ja
10	AVDUL METUSHAJ	2074	160/15		ullishte					115,500	**115,500**	P.verbal/Konf. nga ASHK-ja
11	IMER MERKAJ	2074	160/11		ullishte					154,000	**154,000**	P.verbal/Konf. nga ASHK-ja
12	XHEMIL HAMZAJ	2074	152/4		ullishte					344,000	**344,000**	P.verbal/Konf. nga ASHK-ja
13	NIAZI ISUF HASANAJ	2074	160/8		ullishte					224,000	**224,000**	P.verbal/Konf. nga ASHK-ja
14	BP FEJZAJ, BELAJ, TOZAJ	2074	553/6		ullishte					76,000	**76,000**	P.verbal/Konf. nga ASHK-ja
15	QIRJAKO NOÇKA	8605	56/92		ullishte					768,000	**768,000**	P.verbal/Konf. nga ASHK-ja
16	BP RISILIA ,BUDO,SHEHAJ	1061	76			kullotë				1,620,000	**1,620,000**	Pverbal.
17	BP RISILIA ,BUDO,SHEHAJ	1061	81			kullotë						Pverbal.
18	BP RISILIA ,BUDO,SHEHAJ	1061	87+88			kullotë						Pverbal.
19	BP RISILIA ,BUDO,SHEHAJ	1061	76			kullotë	25490	4156	200	831,200	**831,200**	V. hipotekor
20	BP RISILIA ,BUDO,SHEHAJ	1061	81			kullotë	3600	562	200	112,400	**112,400**	V. hipotekor
21	BP RISILIA ,BUDO,SHEHAJ	1061	87+88			kullotë	8070	2613	200	522,600	**522,600**	V. hipotekor
22	FEJZI PREMTAJ	2074	160/23		ullishte		2820	850	204	173,400	**173,400**	Konf. nga ASHK-ja
23	AZEM SELMANAJ	3401	115/2			kullotë	1700	508	241	122,428	**122,428**	Konf. nga ASHK-ja
24	KIMET BATJAR HOXHAJ	2074	887/1/1		ullishte		1330	550	204	112,200	**112,200**	Konf. nga ASHK-ja
25	QIRJAKO NOÇKA	8605	56/92		ullishte		14000	2781	204	567,324	**567,324**	Konf. nga ASHK-ja
26	ADHURIM DERAJ	2074	941/2		ullishte		1370	835	204	170,340	**170,340**	Konf. nga ASHK-ja
	TOTALI									8,544,392	**8,544,392**	

KËRKESË
Nr. 37/9, datë 14.6.2021

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Agjencia Shtetërore për Shpronësimet shpall kërkesën për shpronësim për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga projekti "Ndërtimi i Rrjetit të Kanalizimeve (KUZ) nga Ujësjellës-Kanalizime sh.a., lagjja 'Mbrostar', Fier".

Subjekti kërkues i këtij projekti është Bashkia Fier.

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim, për interes publik, për pasuritë e paluajtshme, pronë private, të cilat do të kompensohen sipas vlerësimit paraprak të llogaritur, bazuar në VKM-në nr. 89, datë 3.2.2016, "Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë".

Personat që preken nga ky projekt, të cilët kanë emrin në tabelën e publikuar dhe personat të cilët preken por nuk figurojnë në këto lista, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga publikimi në Fletoren Zyrtare, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre, të shoqëruara me dokumentacionin përkatës, si edhe të shprehen nëse janë dakord me të dhënat e publikuara për përfundimin e procedurave të shpronësimit, në Bashkinë Fier, si dhe në Agjencinë Shtetërore për Shpronësimet.

Vlera totale paraprake e shpronësimit është 202,878 (dyqind e dy mijë e tetëqind e shtatëdhjetë e tetë) lekë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
KRYETAR I KOMISIONIT TË POSAÇËM
TË SHPRONËSIMEVE
Erlis Hereni

LISTA PARAPRAKE E PRONARËVE PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT "NDËRTIMI I RRJETIT TË KANALIZIMEVE (KUZ) NGA UJËSJELLËS-KANALIZIME SHA LAGJJA 'MBROSTAR', FIER"

Nr.	Emër Atësi Mbiemër	ZK	Nr. i pasurisë	Lloj i pasurisë	Sip. Totale m²	Sip. e shpronësuar/ m²	Çmimi në lek/m²	Vlera totale për shpronësim	Shënime
1	Urani Prifti	8533	13/66	Truall		18,4	11.026	**202,878**	Konfirmuar nga ASHK-ja
	Vlera totale				**-**	**18,4**		**202,878**	

Shënim.
1. Për tokën "truall", çmimi i llogaritur është marrë nga vendimi nr. 89, datë 3.2.2016, i Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë".

KËRKESË

Shtetasja Parsije Murataj kërkon pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë shpalljen të zhdukur të shtetasit Behari Murataj, lindur në Bubës, Përmet, më 8.10.1951, dhe banues në Tiranë.

KËRKUES
Parsije Murataj

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Vulosur elektronikisht nga Qendra e Botimeve Zyrtare
Viti: 2021 - Numri: 95
Datë: 2021/06/17 15:53:19
85a0eee9-554f-48f8-a1b4-5c626298c025

Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë të një procedure automatike nga një sistem elektronik (Qendra e Botimeve Zyrtare)

Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2021

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 80 lekë